



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3813 Prot.

Roskovec, më 30, 07 2020

VENDIM

NR. 62 .DATË 28.07.2020

“PËR DHËNIEN ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE TË PANDARË NË PRONËSI TË BASHKISË ROSKOVEC”

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2 shkronja “a” dhe shkronja “c”, si dhe nenit 54 shkronja “e” të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; të neneve 826 e në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë; nenit 2 të Ligjit nr. 8312 "Për tokat bujqësore të pandara"; pikes 4 të Vkm 531 date 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara " i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Dhënie me qira të tokës bujqësore konkretisht pasurinë me nr.406/1 "tokë arë" me sipërfaqe totale 100.000 m² e ndodhur në Roskovec, Fier, zona kadastrale Nr.3196 , e regjistruar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier në volumn 15 faqe 164, fakti i cili rezulton nga certifikata e pronësisë me Nr.438237 serie datë 15.11.2011.
2. Procedura e dhënies me qira do të vijohet sipas Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" nga komisioni i qiradhënies së tokës bujqësore të pandarë (KQTBP) i cili do të ngrihet me urdhër të kryetarit të bashkisë.
3. Ngarkohet Komisioni i Qiradhënies së Tokës Bujqësore të Pandare (KQTBP) për zbatimin e tij.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Kadri Hyska

